

Përshëndetje të gjithëve.

Tashmë është bërë traditë që në çdo fillim viti, të takohemi së bashku dhe të diskutojmë mbi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë mes biznesit që aderon pranë Dhomës Amerikane të Tregtisë dhe Administratës Doganore.

Por në këtë takim, që unë më shumë do ta quaja bashkëbisedim, bashkë me stafin teknik do shpjegojmë se çfarë kemi arritur gjatë vitit të kaluar, por edhe atë që në parashikojmë të përmirësojmë gjatë këtij viti.

Viti që lamë pas ishte i vështirë për të gjithë Ne, ku pati ndikime të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në jetën tonë, por edhe në aktivitetin e sipërmarrjeve tuaja.

Shumë biznese u preken nga tërmeti shkatërrues i 26 Nëntorit, por edhe ne si Administratë Doganore patëm dëmtime të mjediseve tona, por me një menaxhim të shpejtë arritëm që puna dhe shërbimi ndaj biznesit të mos ndërpritej për asnjë moment.

Roli i sipërmarrjes është konsideruar si një “motor” zhvillimi në ekonominë e vendit, ndërkohë që Qeveria një ndër prioritetet kryesore ka krijimin e një klime të favorshme për biznesin. Në këtë pikë roli i Administratës Doganore është mjaft i rëndësishëm dhe kyç në këtë klimë.

Por edhe pse viti që lamë pas, ashtu sic e theksova më lart ishte i vështirë, Administrata Doganore pati arritje, disa prej të cilave më lejoni t’ua bëj më dije:

1. Implementuam “Dogana pa letër”,
2. 400 mijë deklarime nga Maji 2019 janë bërë online
3. Përmirësuam shërbimet ndaj bizneseve
4. Reduktuam kohën e përpunimit të deklaratave doganore

5. Forcuam kontrollet me qëllim rritjen e sigurisë kombëtare në Pikat e Kalimit Kufitar
6. Forcuam bashkëpunimit me agjensitë ligjzbatuese vendase dhe ato homologe
7. Krijua lehtësira për të bërë biznes nëpërmjet hapjes së pikave të përbashkëta të kalimit kufitar me vendet fqinje, si dhe hapja e Zyrës Doganore të Kosovës në Portin e Durrësit

Por cilat janë disa nga objektivat që Ne si Administratë Doganore kemi për këtë vit?

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet online për qytetarët dhe bizneset nëpërmjet platformës E- albania .

Në kuadër të Revolucionit Digjital, objektivi ynë është që autorizimet të merren nëpërmjet Platformës E-Albania, cka ndryshon komplet rikonceptimin e ndërveprimit aktual për shërbimet, ku elementi kryesor është jo vetëm aplikimi online nga ana e subjektit, por dhe vendimmarrja totalisht në mënyrë elektronike nga administrata doganore, pra që dhe autorizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave apo Degëve Doganore të jetë i nënshkruar elektronikisht.

Nga 1 Janari i këtij viti Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ofron 8 shërbime online, ndëkohë që në Qershor do të shtohen edhe 22 shërbime të tjera.

Ndërkohë që punonjësit e DPD dhe Degëve Doganore janë orientuar që të asistojnë çdo qytetar apo biznes, në lidhje me këtë transformim të rëndësishëm, i cili synon lehtësimin e praktikave dhe shkurtimin e rradhëve të pritjes.

Gjithashtu në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganës, si dhe në rrjetet sociale apo në të gjitha zyrat në terren, ofrohet informacioni i nevojshëm në lidhje me këto shërbime online.

Për të lehtësuar gjithashtu komunikimin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe nëpër Degët Doganore kemi ngritur Pikat Informuese për Qytetarët/Bizneset (Info Point) .

Edhe këtë vit një ndër objektivat tonë vijon të mbetet standartizimi i proceseve të vlerësimit (respektimi i metodologjisë së vlerësimit), duke rritur cilësinë e analizës dhe argumentave në vlerësim, transparencën në komunikim, të cilat në jo pak raste kanë qënë objekt i shqetësimit tuaj.

Synimi ynë është trajtimi i barabartë dhe me profesionalizëm i biznesit duke patur transparencë në vendimmarrje. E gjitha kjo brenda kuadrit ligjor dhe në përputhje me Kodin Doganor.

Për të realizuar sa më sipër, Administrata Doganore ka përmirësuar sistemet informatike dhe teknologjike, ka rritur shkëmbimet në kohë reale të informacioneve ndërmjet strukturave brenda vendit dhe homologe, trajnuar stafin e brendhëm dhe agjentët doganorë, që jo në pak raste janë një faktor kyç në marrëdhënien mes nesh.

Një ndër shqetësimet tuaja konstante lidhet me aplikimin e çmimeve sipas dosjes së të dhënave të disponueshme nga ana e administratës doganore.

Gjej rastin që në këtë takim të sotëm t'ju paraqes disa shifra, duke besuar fort edhe në besimin reciprok që duhet të kemi.

Kështu nëse në vitin 2013 përqindja e artikujve që rivlerësoheshin sipas të dhënave të disponueshme nga administrata doganore ishte në masën 19.07 % e numrit total të artikujve kjo shifër në vitin 2019 është reduktuar në 9 % e totalit të artikujve të zhdoganuar.

Ndërkohë po të elimojmë këtu artikujt që vlerësohen me bursë dhe zhdoganimet e makinave të përdorua, këto shifra janë nga 15.51 % në vitin 2013, në 2019 në me pak se 5 % të artikujve.

Por edhe pse shifrat flasin vetë për një reduktim të dukshëm të vlerësimit sipas dosjes së të dhënave të disponueshme, unë vlerësoj shqetësimin tuaj lidhur me përditësimin e këtyre të dhënave.

Një rezultat të prekshëm po jep dhe puna e bërë nga administrata doganore në vitet e fundit për shkurtimin e kohës së zhdoganimit dhe krijimit të një ekuilibri sa më të drejtë ndërmjet lehtësimit të tregtisë së ligjshme dhe ushtrimit të kontroleve dhe ndëshkimit të operatorëve ekonomikë që tentojnë të kryejnë evazion fiskal.

Gjithsesi këtu duhet patur parasysh që kontrolli doganor pavaresisht se perceptohet si kontroll kryesisht fiskal përfshin edhe ruajtjen e sigurisë kombëtare, mbrojtjen e konsumatorëve dhe të mjedisit nga trafiqet e paligjshme.

Niveli i kontrollit fizik në import-eksport nga 8 % për 2018, është ulur në 7.3% në 2019, në raport me numrin e përgjithshëm të deklaratave. Ndërkohë që përqindja e deklaratave pa kontroll doganor (kanali jeshil) ka arritur në 12.12 % , nga 8.6% që ishte në 2018.

- ***Gjatë vitit 2019 është dyfishuar numri i operatorëve ekonomikë që janë përfshirë në kanalin jeshil; është katërfishuar numri i operatorëve ekonomikë që janë përfshirë në kanalin blu, cka do të thotë shkurtim i kohës së përpunimit të deklaratave doganore dhe i kohës së qëndrimit të mallrave në doganë.***
- ***Të gjitha këto masa së bashku me një administrim më të mirë të problemeve të ngritura nga ana juaj ka sjellë si rezultat që***

koha mesatare e përpunimit të një deklarate është reduktuar ndjeshëm, ku nga 144 minuta që ishte në 2018, në 2019 ky proces është realizuar mesatarisht në 112 minuta.

- ***Pra kemi fituar gjysëm orë kohë mesatarisht për cdo deklaratë E përkthyer kjo në kohë na rezultojnë 150 mijë ore/pune të kursyera***

Edhe pse Administrata Doganore në vitet e fundit ka bërë mjaft hapa para, dhe në bashkëpunimin me biznesin, kemi ende rrugë për të bërë.

Sigurisht që kemi dhe mangësi në zbatimin në praktikë të të gjitha lehtësive të krijuara, por mirëpresim dhe do të trajtojmë me seriozitetin maksimal çdo sugjerim tuajin për përmiresim brenda kuadrit ligjor dhe detyrave që ligji i ngarkon administratës doganore.

Këtu sëbashku me mua është dhe stafi drejtues teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me qëllim sqarimin teknik të cdo problematike të ngritur apo që mund të dalë gjatë diskutimeve.

Faleminderit